



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3677/8 prot.

Datë 30.01.2026

V E N D I M
Nr. 169/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.01.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 (Pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Vazhdimi i shqyrtimit në themel të pjesës tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biba-X” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Biba-X” SHPK me NIPT K32618815N dhe

adresë Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50m pranë Karburant "EURODRIN", Tiranë

Operatori ekonomik "NIKA" SHPK me NIPT J76705047U dhe adresë Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skënderbeu, godinë 8-kateshë, kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.p, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Lagjja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr.15, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Operatori ekonomik ankimues “Nika” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-10-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 (Pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 07-11-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 10.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE ARTI SHPK & AG Hpoëer & Construction SHPK	31,120,608.75 lekë	skualifikuar
2. AGBES KONSTRUKSION SHPK	34,530,083.50 lekë	skualifikuar
3. BIBA-X SHPK	34,876,416.75 lekë	skualifikuar
4. NIKI SHPK	36,431,892 lekë	skualifikuar
5. BEQIRI SHPK	36,758,872.50 lekë	kualifikuar
6. DESARET COMPANY SHPK	36,825,369.82 lekë	kualifikuar
7. DEHA 2010 SHPK	37,311,120.00 lekë	kualifikuar
8. MODESTE SHPK	37,459,574.25 lekë	kualifikuar
9. Shendelli SHPK	37,668,645 lekë	kualifikuar
10. NDERTIMI shpk	37,937,571 lekë	kualifikuar
11. 2 N SHPK	37,971,570 lekë	kualifikuar
12. BOE DRINI-1 SHPK & NDREGJONI SHPK	38,080,875.00 lekë	kualifikuar
13. RSM Company SH.P.K	38,323,352 lekë	skualifikuar
14. LIS KONSTRUKSION SHPK	38,986,526.3 lekë	kualifikuar
15. "M U R A T I" SHPK & B93 II SHPK	39,629,275 lekë	kualifikuar
16. BOE J O G I SHPK & S P E K T R I SHPK	39,666,533 lekë	kualifikuar
17. LLAZO SHPK	40,727,789 lekë	kualifikuar

18. BOE GLAVENICA SHPK & VISCONS GROUP SHPK	41,918,856 lekë	kualifikuar
19. K.M.K SHPK	44,976,089 lekë	kualifikuar
20. CARA SHPK & PE - VLA – KU SHPK	46,094,449.80 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 23.12.2025, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 23.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3677/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6205 e operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3677/1 prot., datë 24.12.2025.

II.7. Në datën 26.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3714/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6215 e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3714/1 prot., datë 29.12.2025.

II.9. Me shkresën me nr. 3677/2 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Me shkresën me nr. 11572/32 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion rrugës “Safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3677/3 prot., datë 08.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë.

II.11. Me shkresën me nr. 11572/32 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion rrugës “Safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3677/4 prot., datë 12.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë.

II.12. Me shkresën me nr. 306/1 prot., datë 13.01.2026 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 3677/2 prot., datë 07.01.2026”, protokolluar me tonën me nr. 3677/5 prot., datë 16.01.2026 autoriteti kontraktor ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...] në përgjigje të shkresës suaj nr. 3677/2 prot., datë 07.01.2026 protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 306 prot., datë 12.01.2026 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biba –X” SHPK, ju informojmë se autoriteti kontraktor Bashkia Fier, ju ka dërguar vendimin nr. 11572/31 prot., datë 07.01.2026 të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK [...]”.

II.13. Me shkresën me nr. 11572/34, datë 12.01.2026 me lëndë: “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion rrugës “safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3714/2 prot., datë 12.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë si vijon:

“[...] 1.Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik NIKA SHPK, subjekti ankimues, pika 1, pretendimi sipas përmbajtjes së ankesës:

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në lidhje me këtë kriter është vlerësuar se:

Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, germa "a" të DST-së, për disponimin e mjetit "Greider", OE ka dorëzuar vetëm faturën doganore nr. R19897, datë 21.03.2008. Bazuar në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike" përcaktohet se: "Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e rregjistrimit". Pra, si dokumentacion provues për mjetin "Greider", OE NIKA SHPK, me NUIS J76705047U në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon.

[...] KSHA bazuar në tërësinë e dokumentacionit të sipërcituar, si dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar fizikisht pjesë e dosjes së prokurimit pasqyruar dhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim Procesverbal nr. 5 "Mbi marrjen në dorëzim dhe verifikim të dokumentave të operatorit ekonomik i kualifikuar i pari", nga OE "Nika" SHPK, me nr. 11572/19 prot., datë 10.12.2025 të administruara fizikisht në dosjen e kësaj procedure prokurimi konstaton se nga ana e OE NIKA SHPK

- Për mjetet Grejder ka paraqitur dokumentacionin fizik, të noterizuar njësia me origjinalin, faturën doganore nr. 19897, datë 21.03.2008, bashkëshoqëruar me foto ilustruese të mjetit nga ku evidentohet Grejder me goma;

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi i rrugor i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugën e makinave teknologjike" përcaktohet se: "Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit", si dhe bazuar në kërkesën e DST-së për pikën 2.3.5. germa (a) ku përcaktohet se:

"a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatat e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit".

KSHA vlerëson se, OE NIKA SHPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon,, dhe në këto kushte nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është përmbushur kriteri i kualifikimit i kërkuar në DST;

-Po kështu edhe përsa i përket pretendimit në ankesë të O.E për mjetin "Asfaltoshtruese", bazuar në dokumentacionin fizik të paraqitur, të noterizuar njësia me origjinalin, OE ankimues ka paraqitur dokumentacionin fizik faturën doganore nr. 77259, datë 11.06.2005, bashkëshoqëruar me foto ilustruese të mjeteve, nga ku evidentohet mjeti me goma, prandaj

bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi i rrugës së republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "Makinat" teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugën e makinave teknologjike" përcaktohet se: "Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlevizuese dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit", si dhe bazar në kërkesën e DST-së për pikën 2.3.5 gjatë (a) ku përcaktohet se:

"a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatat e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit,"

[...] **KSHA vlerëson se**, OE NIKA SHPK në përmbushje të kriterëve të DST, pra bazuar në kriteret e vendosura në DST, si dhe bazuar në përcaktimet ligjore të normuara nga Kodi Rrugor, edhe për këtë mjet, O.E. duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon, dhe në këto kushte vlerësohet se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është përmbushur kriteri i kualifikimit i kërkuar në DST;

Theksojmë se KSHA ka shqyrtuar këto pretendime të OE ankimues bazuar në mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik, legjislacionit në fuqi të normuara nga ligjvënësi, dhe dokumentacionit të rrethanave konkrete të kësaj procedure prokurimi publik

Pra, në lidhje me këto pretendime të operatorit ankimues, (pika 1 e pretendimeve në ankesë) për mjetet (Grejder dhe Asfaltoshtruese), të kërkuara nga A.K. në DST, dhe të vlerësuara nga KVO, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur prej tij për përmbushjen e këtij kriteri, KSHA vlerëson se nga ana e O.E. ankimues nuk janë përmbushur kërkesat ligjore të përcaktuara në DST. Pra, pretendimi i OE ankimues është i pabazuar në prova dhe në ligj.

KSHA vlerëson se pretendon i OE ankimues për këto pika të shqyrtuara si më sipër nuk qëndron dhe nuk pranohen.

- 2. Referuar formularit të analizës së bërë nga operatori ekonomik "NIKA" SHPK. **Subjekti ankimues, pika 2, pretendon sipas përmbajtjes së ankesës:**
- Nga **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** në lidhje me këtë pikë është vlerësuar arsyeja e skualifikimit si më poshtë:

"Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma "b" të DST-së Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ne nje nga format e njohura nga legjislacioni ne fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, OE nuk ka dorëzuar kontrate

noteriale por ka dorezuar një kontratë qeraje Nr.2 te nenshkuar midis dy paleve jo sipas specifikimeve të DST."

- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në DST-së, nga ana e **Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier**, në kërkesat për kualifikim të DST-së, në shtojcën 7, në pikën 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 2.3.5., rubrika "Shënim", gërma "b", të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për përmbushjen e këtij kriteri konkretisht përcaktohet dhe është kërkuar i më poshtë: [...]
- [...] Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar fizikisht nga ana e OE NIKA shpk dhe në Formularin e vetëdeklarimit të këtij të fundit (të administruar në dosjen përkatëse), KSHA konstaton se ky OE në përmbushje të kriterëve teknike për disponimin e mjeteve ka paraqitur kontratë qiraje nr. 2 të datës 02.11.2025 për mjetet "autobitumatrice" dhe "Rul me vibrim Dynapac", kontratë qiraje për mjete e lidhur midis shoqërive "V..." shpk në rolin e qiradhanësit dhe shoqërisë "NIKA" shpk në rolin e qiramarrësit, baza ligjore "Neni 801 e vijues të K.Civil".

Referuar kërkesave të përcaktuara në shtojcën 7 të DST së kësaj procedure prokurimi, në lidhje me këtë pikë, autoriteti kontraktor (njësia e prokurimit) ka përracktuar se "për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti.....si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ose në një format e njohura nga legjislacioni në fuqi, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të objektit të kontratave objekt prokurimi.

Vërehet se referuar dokumentacionit të dosjes, KVO nuk ka pretendime mbi elementët e tjerë të kësaj Kontrate Qira për Mjete (Nr.2, datë 02.11.2025), por i referohet faktit se kjo Kontratë nuk është noteriale, duke vlerësuar se OE ankimes "ka dorëzuar një kontratë qeraje Nr.2 të nënshkuar në mes të dy palëve jo sipas specifikimeve të DST", ndërsa në kërkesën e kryer në shtojcën 7 të DST së kësaj procedure prokurimi (pika 2.3 "Kapaciteti teknik". pika 2.3.5., rubrika "Shënim", germa "b"), autoritet kontraktor (njësia e prokurimit) ka të bëjë me faktin se duhet të përmbushet "Për mjetet e siguruara me garanci, duhet të paraqesë shoqërohet me kontrata të zbatueshme noteriale të garancisë ose në një format të njohur nga legjislacioni në fuqi.....".

Pra, KVO në vlerësimin e saj të cilit duhet të jetë bazar rigorozisht në kërkesën e autoritetit kontraktor të përpunuar në shtojcën 7 të DST (si më parë i cituar), nuk ka marrë në konsideratë faktin e përcaktuar në DST që kontratat e qirasë së mjeteve mund të paraqiten edhe në një format të njohur nga legjislacioni në fuqi, përveç formës së kontratës noteriale.

Për sa kohë që autoritet kontraktor (njësia e prokurimit) ka kryer në shtojcën 7 të DST dy mënyra të paraqitjes së kontratës së qirasë, pra ose me kontratën përkatëse noteriale të qirasë ose në një format e njohura nga legjislacioni në fuqi, dhe për sa kohë Kontrata e qirasë nr. 2

e datës 02.11.2025 për mjetet "Autobitumatrice" dhe "Rul me vibrim Dynapac", është bazuar dhe plotëson të gjitha elementet e parashikuara nga neni 801 në vijim të Kodit Civil, pra është Kontrata e lidhur në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi (bazuar në Kodin Civil të RSH), atëherë dhe vlerësimi i saj duhet të bëhet në përputhje me kërkesën apo alternativën kualifikuese që ka përcaktuar vetë autoriteti kontraktor (njësia e prokurimit) në shtojcën 7 të DST.

Baza në dispozitat ligjore pika 3, të nenit 92 të LLP-së parashihet se "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratave dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji." Për pasojë, KSHA gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të vlerësohen referuar kërkesave të vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimin e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me këtë kërkesë, siç janë cituar apo formuluar nga autoritet kontraktor në DST.

KSHA vlerëson se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë pikë qëndron dhe pranohet.

3. Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "NIKA SHPK". **Subjekti ankimues, pika 3, pretendon se:**

Nga **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** në lidhje me këtë pikë është vlerësuar arsyeja e skualifikimit si më poshtë:

"OE nuk ka paraqitur formularin e ofertës dhe listen e ccmimeve të korrigjuar me dokumentacionin e dorëzuar fizikisht."

- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në DST e kësaj procedure prokurimi përcaktohet dhe është kërkuar si më poshtë:

"Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoritet kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h". "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqërore të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente

duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim.

Bazuar në dokumentacionin të administruar në dosjen e prokurimit rezulton se nga KVO gjatë procesit të shqyrtimit të ofertës ekonomike, KVO është e drejtuar O.E NIKA SHPK në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) me kërkesën "Për korrigjimin e gabimit aritmetik në lidhje me ofertën e paraqitur", administruar në dosje me nr. 11572/9 prot., datë 10/11/2025, duke përcaktuar afat dorëzimi të materialit në datën 13/11/2025 në SPE ose pranë Autoritetit të Kontraktorit Bashkia Fier brenda orarit zyrtar të punës.

Konstatohet se nga O.E. NIKA Shpk vetëm nëpërmjet SPE-së, më 11/11/2021, mentacioni "Shkresë" me lënde. Kërkesë për dorëzim dokumentash përcjellëse-saktësuese, bashkëlidhur preventivi i punimeve.

Nuk rezulton nga materiali i administruar në dosjen e prokurimit që ky dokumentacion i ngarkuar në SPE të jetë dorëzuar fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier.

Në datë 02/12/2025 nga KVO me anë të SPE-së O.E NIKA SHPK i klasifikuar i pari, i është dërguar "Kërkesë për paraqitje dokumentacioni provues të vetëdeklarimit dhe dokumentave të tjera shoqërues të ofertës", administruar fizikisht në dosje me nr. 11572/18 Prot., datë 02/12/2025 duke i atachuar materialin, nëpërmjet sistemit elektronik ku OE NIKA SHPK i klasifikuar i pari i kërkohet paraqitje dokumentacioni bazuar në nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Në DST përcaktohet se:

"Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoritet kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h". "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqërore të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim.

Rezulton se nga O.E NIKA SHPK është depozituar dokumentacioni fizik në përgjigje të kërkesës së KVO-së, me shkresë nr. 112 prot., datë 04/12/2025, protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 13759 Prot., datë 04/12/2025.

Rezulton se me procesverbalin Nr. 5 "Mbi marrjen në dorëzim dhe verifikimin e dokumenteve fizike të O.E.NIKA SHPK" me nr. 11572/19 Prot., datë 10/12/2025, KVO ka marrë në dorëzim dhe shqyrtuar dokumentacion fizik të dorëzuar nga NIKA shpk, nga ku evidentohet fakti se formulari i ofertës dhe preventivi i dorëzuar sipas këtij procesverballi dhe kësaj praktike dorëzuese, është formulari dhe preventivi me gabime aritmetike (para korrigjimit), pra OE NIKA shpk nuk ka sjellë/dorëzuar fizikisht formularin e ofertës ekonomike dhe preventivin e punimeve të korrigjuar, të cilin e ka ngarkuar vetëm në SPE, kur i është kërkuar nga KVO, në fazën e shqyrtimit të ofertave.

Ky fakt pranohet nga vetë O.E. ankimues NIKA SHPK, i cili në ankesën e tij citon se në momentin e dorëzimit fizik të dokumentimit është dorëzuar "edhe formulari dhe lista e çmimeve me gabime në llogaritje".

Gjithashtu, në paragrafin e dytë të kësaj pike të ankesës, O.E. ankimues NIKA SHPK citon se: "kjo mund të bëhet me kërkesë të re për dorëzimin e dokumentacionit dhe dokumentacioni ishte gati"

Baza në Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", bazuar në nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe bazuar edhe në evidentimin e qartë në DST të këtij rregulli, OE I klasifikuar i pari ka detyrimin ligjor që të dorëzojë fizikisht pranë autoritetit kontraktor, jo vetëm dokumentet provuese për vetëdeklarimet që ka bërë por edhe "dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike".

Vetë fryma e ligjvënësit në kërkesat ligjore të detyrueshme për zbatim, përcakton detyrimin e AK për vendosjen dhe referimin e tyre fazës së vlerësimit të ofertave, si dhe detyrimin e O.E. pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të përgatisin ofertat e tyre ekonomike të përgjegjshme dhe të vlefshme (neni 93), dhe të zbatojnë rregullat e prokurimit sicc ato përcaktohen nga AK dhe nga ligjvënësi në rregullat e prokurimit publik.

Konkretisht, evidentimi i mësipërm në referim të përcaktimeve ligjore "Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara".

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim", në momentin procedural të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentimit fizik të dorëzuar nga OE i klasifikuar i pari konform rregullave të prokurimit publik, kur ky i fundit nuk ka dorëzuar dokumentet e ofertaës fizikisht, sicc përcaktojnë rregullat e prokurimit publik, për të shkak të skualifikim të këtij OE.

Gjithashtu, kërkesa e AK që OE i klasifikuar i pari të dorëzojë fizikisht dhe në origjinal dokumentin e garës "Formular oferte dh preventiv" (të rregullt), është një garanci për lidhjen

e kontratës dhe sigurimin e autoritetit kontraktor për realizimin e objektit të prokurimit.
.....

KSHA vlerëson se pretendimi i OE ankimues për këtë pikë të shqyrtuar si më sipër, nuk qëndron dhe nuk pranohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendosi

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "NIKA" Sh.P.K NUIS J76705047U, për procedurën e prokurimit publik me objektin "Rikonstruksion Rruga "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier", me nr. REF-65205-10-15-2025, me limit fondi 57 650 770.11 (Pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të zhvilluar në datë 07/11/2025 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier [...].*

II.14 Me shkresën me nr. 11572/34, datë 12.01.2026 me lëndë: "Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt "Rikonstruksion rrugës "safet Alushi". Fshati "Drizë", Njësia administrative Qendër Fier", me nr. REF-65205-10-15-2025", protokolluar me tonën me nr. 3714/3 prot., datë 14.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Nika" SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë si më sipër cituar.

II.15. Me shkresën me nr. 3714/4 prot., datë 19.01.2026 me lëndë "Kërkesë për informacion", Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë Komisionit kopje të njehuar me origjinalin me vulë sekretarie të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik "Nika" SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

II.16. Me shkresën me nr. 1024 prot., datë 26.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3714/4 prot., datë 28.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së kopje të njehuar me origjinalin me vulë sekretarie të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik "Nika" SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

II.17. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur

argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BIBA-X” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 16-10-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

III.1.2. Në datën 07-11-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 10.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE ARTI SHPK & AG Hpoëer & Construction SHPK	31,120,608.75 lekë	skualifikuar
2. AGBES KONSTRUKSION SHPK	34,530,083.50 lekë	skualifikuar
3. BIBA-X SHPK	34,876,416.75 lekë	skualifikuar
4. NIKA SHPK	36,431,892 lekë	skualifikuar
5. BEQIRI SHPK	36,758,872.50 lekë	kualifikuar
6. DESARET COMPANY SHPK	36,825,369.82 lekë	kualifikuar
7. DEHA 2010 SHPK	37,311,120.00 lekë	kualifikuar
8. MODESTE SHPK	37,459,574.25 lekë	kualifikuar
9. Shendelli SHPK	37,668,645 lekë	kualifikuar
10. NDERTIMI shpk	37,937,571 lekë	kualifikuar
11. 2 N SHPK	37,971,570 lekë	kualifikuar
12. BOE DRINI-1 SHPK & NDREGJONI SHPK	38,080,875.00 lekë	kualifikuar
13. RSM Company SH.P.K	38,323,352 lekë	skualifikuar
14. LIS KONSTRUKSION SHPK	38,986,526.3 lekë	kualifikuar

15. "M U R A T I" SHPK & B93 II SHPK	39,629,275 lekë	kualifikuar
16. BOE J O G I SHPK & S P E K T R I SHPK	39,666,533 lekë	kualifikuar
17. LLAZO SHPK	40,727,789 lekë	kualifikuar
18. BOE GLAVENICA SHPK & VISCONS GROUP SHPK	41,918,856 lekë	kualifikuar
19. K.M.K SHPK	44,976,089 lekë	kualifikuar
20. CARA SHPK & PE - VLA – KU SHPK	46,094,449.80 lekë	skualifikuar

III.1.4. Në datën 23.12.2025, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

III.1.5. Në datën 23.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3677/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6205 e operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3677/1 prot., datë 24.12.2025.

III.1.7. Me shkresën me nr. 3677/2 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III.1.8. Me shkresën me nr. 11572/32 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion rrugës “safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3677/3 prot., datë 08.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë.

III.9. Me shkresën me nr. 11572/32 prot., datë 08.01.2026 me lëndë “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion rrugës “safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3677/4 prot., datë 12.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë.

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.11. Në nenin 97 pika 2 dhe 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“2.Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

III.1.12. Në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit,, **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.** Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....; “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: “... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përlllogaritjen e

afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar siç është procedura e prokurimit objekt ankimi, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

III.1.13. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar me datë 23.12.2025. KPP vëren, se me datë 23.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2025/6205, dhe me Nr. 3677/2025 Prot., datë 23.12.2025 e operatorit ekonomik “BIBA-X” SHPK. Ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se në këtë datë (23.12.2025) kur është paraqitur ankesa nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pavarësisht se ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak, afati i ankimit nuk kishte filluar të ecte për operatorët ekonomikë pjesëmarrës pasi në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse, Gjithashtu edhe në vlerësim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit **afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**,

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike përpara afatit të parashikuar nga neni 97 pika 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”, por edhe nga vlerësimi që Gjykata Administrative e Apelit përmes vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 i ka bërë nisjes së llogaritjes së afatit të ankimit administrativ. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar ende, për sa kohë sipas parashikimeve më sipër dita e

publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (data 23.12.2025 kur edhe është paraqitur në sistem ankesa) nuk përfshihet në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar me datë 23.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.15. Lidhur me vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj., përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik mbi afatet e ankimit administrativ rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i

kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit, duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik dhe referuar ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK është në kundërshtim të plotë me aktet në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Me shkresën me nr. 11572/34, datë 12.01.2026 me lëndë: “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstrukcion rrugës “safet Alushi”. Fshati “Drizë”, Njësia administrative Qendër Fier”, me nr. REF-65205-10-15-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3714/2 prot., datë 12.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë si vijon:

“[...] 1.Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik NIKA SHPK, subjekti ankimues, pika 1, pretendimi sipas përmbajtjes së ankesës:

- *Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në lidhje me këtë kriter është vlerësuar se:*

Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma “a” të DST-së, për disponimin e mjetit “Greider”, OE ka dorëzuar vetëm faturën doganore nr. R19897, datë 21.03.2008. Bazuar në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makunave teknologjike” përcaktohet se: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e rregjistrimit”. Pra, si dokumentacion provues për mjetin “Greider”, OE NIKA SHPK, me NUIS J76705047U në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon.

[...] KSHA bazuar në tërësinë e dokumentacionit të sipërcituar, si dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar fizikisht pjesë e dosjes së prokurimit pasqyruar dhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim Procesverbal nr. 5 “Mbi marrjen në dorëzim dhe verifikim të dokumentave të operatorit ekonomik i kualifikuar i pari”, nga OE “Nika” SHPK, me nr. 11572/19 prot., datë

10.12.2025 të administruara fizikisht në dosjen e kësaj procedure prokurimi konstaton se nga ana e OE NIKA SHPK

- Për mjetet Grejder ka paraqitur dokumentacionin fizik, të noterizuar njësia me origjinalin, faturën doganore nr. 19897, datë 21.03.2008, bashkëshoqëruar me foto ilustruese të mjetit nga ku evidentohet Grejder me goma;

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi i rrugor i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugën e makinave teknologjike" përcaktohet se: "Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit", si dhe bazuar në kërkesën e DST-së për pikën 2.3.5. germa (a) ku përcaktohet se:

"a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatat e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit".

KSHA vlerëson se, OE NIKA SHPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon,, dhe në këto kushte nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është përmbushur kriteri i kualifikimit i kërkuar në DST;

-Po kështu edhe përsa i përket pretendimit në ankesë të O.E për mjetin "Asfaltoshtruese", bazuar në dokumentacionin fizik të paraqitur, të noterizuar njësia me origjinalin, OE ankimues ka paraqitur dokumentacionin fizik faturën doganore nr. 77259, datë 11.06.2005, bashkëshoqëruar me foto ilustruese të mjeteve, nga ku evidentohet mjeti me goma, prandaj bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi i rrugës së republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugën e makinave teknologjike" përcaktohet se: "Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit", si dhe bazuar në kërkesën e DST-së për pikën 2.3.5 gjatë (a) ku përcaktohet se:

"a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatat e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit,"

[...] KSHA vlerëson se, OE NIKA SHPK në përmbushje të kriterëve të DST, pra bazuar në kriteret e vendosura në DST, si dhe bazuar në përcaktimet ligjore të normuara nga Kodi Rrugor, edhe për këtë mjet, O.E. duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë

së mjetit, dokumentacion i cili mungon, dhe në këto kushte vlerësohet se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është përmbushur kriteri i kualifikimit i kërkuar në DST;

Theksojmë se KSHA ka shqyrtuar këto pretendime të OE ankimues bazuar në mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik, legjislacionit në fuqi të normuara nga ligjvënësi,, dhe dokumentacionint e rrethanave konkrete të kësaj procedure prokurimi publik

Pra, në lidhje me këto pretendime të operatorit ankimues, (pika 1 e pretendimeve në ankesë) për mjetet (Grejder dhe Asfaltoshtruese), të kërkuara nga A.K. në DST, dhe të vlerësuara nga KVO, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur prej tij për përmbushjen e këtij kriteri, KSHA vlerëson se nga ana e O.E. ankimues nuk janë përmbushur kërkesat ligjore të përcaktuara në DST. Pra, pretendimi i OE ankimues është i pabazuar në prova dhe në ligj.

KSHA vlerëson se pretendon i OE ankimues për këto pika të shqyrtuara si më sipër nuk qëndron dhe nuk pranohen.

- 2. Referuar formularit të analizës së bërë nga operatori ekonomik "NIKA" SHPK. **Subjekti ankimues, pika 2, pretendon sipas përmbajtjes së ankesës:**
- Nga **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** në lidhje me këtë pikë është vlerësuar arsyeja e skualifikimit si më poshtë:

"Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma "b" të DST-së Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ne nje nga format e njohura nga legjislacioni ne fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, OE nuk ka dorëzuar kontrate noteriale por ka dorezuar një kontratë qeraje Nr.2 te nenshkruar midis dy paleve jo sipas specifikimeve të DST."

- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në DST-së, nga ana e **Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier**, në kërkesat për kualifikim të DST-së, në shtojcën 7, në pikën 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 2.3.5., rubrika "Shënim", gërma "b", të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për përmbushjen e këtij kriteri konkretisht përcaktohet dhe është kërkuar i më poshtë: [...]
- [...] Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar fizikisht nga ana e OE NIKA shpk dhe në Formularin e vetëdeklarimit të këtij të fundit (të administruar në dosjen përkatëse), KSHA konstaton se ky OE në përmbushje të kriterëve teknike për disponoimin e mjeteve ka paraqitur kontratë qiraje nr. 2 të datës

02.11.2025 për mjetet “autobitumatrice” dhe “Rul me vibrim Dynapac”, kontratë qiraje për mjete e lidhur midis shoqërive “V...” shpk në rolin e qiradhanësit dhe shoqërisë “NIKA” shpk në rolin e qiramarrësit, baza ligjore “Neni 801 e vijues të K.Civil”.

Referuar kërkesave të përcaktuara në shtojcën 7 të DST së kësaj procedure prokurimi, në lidhje me këtë pikë, autoriteti kontraktor (njësia e prokurimit) ka përcaktuar se “për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti.....si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ose në një format e njohura nga legjislacioni në fuqi, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të objektit të kontratave objekt prokurimi.

Vërehet se referuar dokumentacionit të dosjes, KVO nuk ka pretendime mbi elementët e tjerë të kësaj Kontrate Qira për Mjete (Nr.2, datë 02.11.2025), por i referohet faktit se kjo Kontratë nuk është noteriale, duke vlerësuar se OE ankimes “ka dorëzuar një kontratë qiraje Nr.2 të nënshkruar në mes të dy palëve jo sipas specifikimeve të DST”, ndërsa në kërkesën e kryer në shtojcën 7 të DST së kësaj procedure prokurimi (pika 2.3 “Kapaciteti teknik”. pika 2.3.5., rubrika “Shënim”, germa “b”), autoritet kontraktor (njësia e prokurimit) ka të bëjë me faktin se duhet të përmbushet “Për mjetet e siguruar me garanci, duhet të paraqesë shoqërohet me kontrata të zbatueshme noteriale të garancisë ose në një format të njohur nga legjislacioni në fuqi.....”.

Pra, KVO në vlerësimin e saj të cilit duhet të jetë bazar rigorozisht në kërkesën e autoritetit kontraktor të përpunuar në shtojcën 7 të DST (si më parë i cituar), nuk ka marrë në konsideratë faktin e përcaktuar në DST që kontratat e qirasë së mjeteve mund të paraqiten edhe në një format të njohur nga legjislacioni në fuqi, përveç formës së kontratës noteriale.

Për sa kohë që autoritet kontraktor (njësia e prokurimit) ka kryer në shtojcën 7 të DST dy mënyra të paraqitjes së kontratës së qirasë, pra ose me kontratën përkatëse noteriale të qirasë ose në një format e njohura nga legjislacioni në fuqi, dhe për sa kohë Kontrata e qirasë nr. 2 e datës 02.11.2025 për mjetet “Autobitumatrice” dhe “Rul me vibrim Dynapac”, është bazuar dhe plotëson të gjitha elementet e parashikuara nga neni 801 në vijim të Kodit Civil, pra është Kontrata e lidhur në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi (bazuar në Kodin Civil të RSH), atëherë dhe vlerësimi i saj duhet të bëhet në përputhje me kërkesën apo alternativën kualifikuese që ka përcaktuar vetë autoriteti kontraktor (njësia e prokurimit) në shtojcën 7 të DST.

Baza në dispozitat ligjore pika 3, të nenit 92 të LLP-së parashihet se “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratave dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” Për pasojë, KSHA gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të vlerësohen referuar kërkesave të vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimin e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me këtë kërkesë, siç janë cituar apo formuluar nga autoritet kontraktor në DST.

KSHA vlerëson se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë pikë qëndron dhe pranohet.

3. Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "NIKA SHPK". **Subjekti ankimues, pika 3, pretendon se:**

Nga **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** në lidhje me këtë pikë është vlerësuar arsyeja e skualifikimit si më poshtë:

"OE nuk ka paraqitur formularin e ofertës dhe listen e ccmimeve të korrigjuar me dokumentacionin e dorëzuar fizikisht."

- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në DST e kësaj procedure prokurimi përcaktohet dhe është kërkuar si më poshtë:

"Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoritet kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h". "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqërore të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim.

Bazuar në dokumentacionin të administruar në dosjen e prokurimit rezulton se nga KVO gjatë procesit të shqyrtimit të ofertës ekonomike, KVO është e drejtuar O.E NIKA SHPK në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) me kërkesën "Për korrigjimin e gabimit aritmetik në lidhje me ofertën e paraqitur", administruar në dosje me nr. 11572/9 prot., datë 10/11/2025, duke përcaktuar afat dorëzimi të materialit në datën 13/11/2025 në SPE ose pranë Autoritetit të Kontraktorit Bashkia Fier brenda orarit zyrtar të punës.

Konstatohet se nga O.E. NIKA Shpk vetëm nëpërmjet SPE-së, më 11/11/2021, mentacioni "Shkresë" me lënde. Kërkesë për dorëzim dokumentash përcjellëse-saktësuese, bashkëlidhur preventivi i punimeve.

Nuk rezulton nga materiali i administruar në dosjen e prokurimit që ky dokumentacion i ngarkuar në SPE të jetë dorëzuar fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier.

Në datë 02/12/2025 nga KVO me anë të SPE-së O.E NIKA SHPK i klasifikuar i pari, i është dërguar "Kërkesë për paraqitje dokumentacioni provues të vetëdeklarimit dhe dokumentave të tjera shoqërues të ofertës", administruar fizikisht në dosje me nr. 11572/18 Prot., datë 02/12/2025 duke i atachuar materialin, nëpërmjet sistemit elektronik ku OE NIKA SHPK i klasifikuar i pari i kërkohet paraqitje dokumentacioni bazuar në nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Në DST përcaktohet se:

"Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoritet kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h". "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqërore të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim."

Rezulton se nga O.E NIKA SHPK është depozituar dokumentacioni fizik në përgjigje të kërkesës së KVO-së, me shkresë nr. 112 prot., datë 04/12/2025, protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 13759 Prot., datë 04/12/2025.

Rezulton se me procesverbalin Nr. 5 "Mbi marrjen në dorëzim dhe verifikimin e dokumenteve fizike të O.E.NIKA SHPK" me nr. 11572/19 Prot., datë 10/12/2025, KVO ka marrë në dorëzim dhe shqyrtuar dokumentacion fizik të dorëzuar nga NIKA shpk, nga ku evidentohet fakti se formulari i ofertës dhe preventivi i dorëzuar sipas këtij procesverbali dhe kësaj praktike dorëzuese, është formulari dhe preventivi me gabime aritmetike (para korrigjimit), pra OE NIKA shpk nuk ka sjellë/dorëzuar fizikisht formularin e ofertës ekonomike dhe preventivin e punimeve të korrigjuar, të cilin e ka ngarkuar vetëm në SPE, kur i është kërkuar nga KVO, në fazën e shqyrtimit të ofertave.

Ky fakt pranohet nga vetë O.E. ankimues NIKA SHPK, i cili në ankesën e tij citon se në momentin e dorëzimit fizik të dokumentimit është dorëzuar "edhe formulari dhe lista e çmimeve me gabime në llogaritje".

Gjithashtu, në paragrafin e dytë të kësaj pike të ankesës, O.E. ankimues NIKA SHPK citon se: “kjo mund të bëhet me kërkesë të re për dorëzimin e dokumentacionit dhe dokumentacioni ishte gati”

Baza në Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", bazuar në nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe bazuar edhe në evidentimin e qartë në DST të këtij rregulli, OE I klasifikuar i pari ka detyrimin ligjor që të dorëzojë fizikisht pranë autoritetit kontraktor, jo vetëm dokumentet provuese për vetëdeklarimet që ka bërë por edhe "dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike".

Vetë fryma e ligjvënësit në kërkesat ligjore të detyrueshme për zbatim, përcakton detyrimin e AK për vendosjen dhe referimin e tyre fazës së vlerësimit të ofertave, si dhe detyrimin e O.E. pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të përgatisin ofertat e tyre ekonomike të përgjegjshme dhe të vlefshme (neni 93), dhe të zbatojnë rregullat e prokurimit sicc ato përcaktohen nga AK dhe nga ligjvënësi në rregullat e prokurimit publik.

Konkretisht, evidentimi i mësipërm në referim të përcaktimeve ligjore “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara”.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen të kushte për skualifikim", në momentin procedural të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentimit fizik të dorëzuar nga OE i klasifikuar i pari konform rregullave të prokurimit publik, kur ky i fundit nuk ka dorëzuar dokumentet e ofertaës fizikisht, sicc përcaktojnë rregullat e prokurimit publik, për të shkak të skualifikim të këtij OE.

Gjithashtu, kërkesa e AK që OE i klasifikuar i pari të dorëzojë fizikisht dhe në origjinal dokumentin e garës “Formular oferte dh preventiv” (të rregullt), është një garanci për lidhjen e kontratës dhe sigurimin e autoritetit kontraktor për realizimin e objektit të prokurimit.

.....

KSHA vlerëson se pretendimi i OE ankimues për këtë pikë të shqyrtuar si më sipër, nuk qëndron dhe nuk pranohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "NIKA" Sh.P.K NUIS J76705047U, për procedurën e prokurimit publik me objektin "Rikonstruksion Rruga "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier", me nr. REF-65205-10-15-2025, me limit fondi 57 650 770.11 (Pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të zhvilluar në datë 07/11/2025 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier [...].

III.2.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NIKA” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, nga verifikimi i shkresës me nr. nr. 11572/34 prot., datë 12.01.2026, dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3714/2 prot., datë 12.01.2026, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3714/2025 prot., datë 29.12.2025 të operatorit ekonomik “NIKA” SHPK.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike si vijon: “[...] Se pari: Skualifikimi i shoqërisë Nika shpk lidhur me mjetet Grejder dhe Asfaltoshtruese është i paligjshëm për dy arsye: Arsyeja e Pare: Në lidhje me arsyen e skualifikimit se për mjetet GREYDER dhe Asfaltoshtruese ne pronesi të OE NIKA SHPK nuk janë paraqitur dokumentet tekniko-ligjore të tilla si, vertetim për regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus Certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksat vjetore dhe Certifikatën e pronesisë së mjetit, targat, sqarime se në shtojcën 8 lidhur me vetdeklarimin e ketyre mjeteve ne kemi deklaruar mjetet Grejder me Kontrate shitblerje mjeti e datës 11.04.2012 dhe Asfaltoshtruese me Deklaratë doganore R 77259 datë 11.06.2025. Po kështu kemi dorëzuar edhe dokumentat lidhur me keto mjete që

jane, deklarate doganore, kontrate shitblerje dhe fotot e mjeteve. KVO qe ne fazen e pare te kesaj procedure, verifikimit te deklarimeve ka konstatuar se per keto mjete nuk jane deklaruar targa dhe numri i shasisë se tij, c`ka do te thote se ne kemi deklaruar nje mjet qe nuk eshte i targuar dhe per te cilin nuk do te paraqisnim dokumentat e kerkuara te tilla si, vertetim per regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus Certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksat vjetore dhe Certifikata e pronesise se mjetit. Pra, ne kete faze eshte bere verifikimi i deklarimit te mjeteve dhe KVO duke qene se per mjetet ne fjale kerkonte qe te ishte i pajisur me targa dhe me dokumentat vertetim per regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus Certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksat vjetore dhe Certifikata e pronesise se mjetit, duhej qe ne fazen e pare te vleresimit te kishte bere skualifikimin e shoqerise Nika shpk per kete shkak. Duke qene se KVO ka verifikuar mjetet Grejder dhe Asfaltoshtruese te deklaruar, te cilat ishin pa targa dhe nuk e ka skualifikuar shoqerine Nika shpk do te thote se ky deklarim eshte i rregullt dhe skualifikimi i tij me vone eshte i padrejte, pasi kjo bie ndesh edhe me jurisprudencen e KPP qe ne rivleresim te procedures nuk mund te nxirren arsye te reja per skualifikim [...].

[...] Arsyeja e Dyte: Lidhur me mjetet Grejder dhe Asfaltoshtruese sqarojme se ato nuk jane mjete qe marrin pjese ne qarkullimin rrugor, por jane mjete qe perdoren ne kantieret e ndertimit dhe pajisja me targe e tyre nuk eshte e detyrueshme, per shkak se per te levizur nga nje objekt ne tjetrin perdoren rimorkaitoret per transportin e tyre dhe nuk qarkullojne vete. Ky pretendim i yni gjen zbatim ne vendimet e KPP me numer 1724, date 20.11.2025 dhe numer 1812, date 09.12.2025 ne tye cilet shprehet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5. autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshtë dhe **argumentohet ne baze te zerave te preventivit:**

Nr	Emërtimi i makinerisë dhe pajisjes	Sasia	Manovrator/Shofer	Shënime	Statusi
1	Ekskavator 1 m3	1	Eskavatorist	Zërat në preventivit me analizë 3.110/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislati në fuqi
2	Autobot	1	Automakinist		

				<i>Zërat në preventiv me analizë 3.212/b</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacio ni në fuqi</i>
3	<i>Betonjere 500 litër</i>	1	-	<i>Zërat në preventiv në lindje me analizë3.243</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacio ni në fuqi</i>
4	<i>Autobitumatr içe</i>	1	<i>Automakinist</i>	<i>Zërat në preventiv me analizë3.226/1, 3.222/2</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacio ni në fuqi</i>
5	<i>Asfaltoshtrus e</i>	1	<i>Buldozerist</i>	<i>Zërat në preventiv me analizë 3.226/1, 3.222/2</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacio ni në fuqi</i>
6	<i>Rul (kompresor) me vibrim</i>	2	<i>Buldozerist</i>	<i>Zërat në preventiv me analizë 3.211, 3.198,3.212,3.212/b,3.226/1,3. 222/2</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose</i>

					<i>në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi</i>
7	<i>Grejder</i>	1	<i>Buldozerist</i>	<i>Zërat në preventiv me analizë 3.211, 3.198, 3.212, 3.212/b</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi</i>
8	<i>Spërkatës boje për vizime në rrugë</i>	1	-	<i>Zërat në preventivat me analizë 3.949/1</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi</i>
9	<i>Vibrator thellësie</i>	1	-	<i>Zërat në preventiv në lindje me analizë 3.243, 2.595</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi</i>
10	<i>Auto vetshkarkues e me kapacitet mbajtës min. 10 ton</i>	2	<i>Shofer me leje drejtimi C</i>	<i>Zërat në preventiv me analizë 3.158/5a, 3.211, 3.198, 3.212, 3.212/b, 3.226/1, 3.222/2, 3.396, 2.261/a, 2.595, 2.288, 3.618, 2.523/1</i>	<i>Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga</i>

					legjislacioni në fuqi
11	Fadrom	1	Eskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.396	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike- praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit" kurse makinerit janë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania.

b) Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë kapacitetet teknike si më poshtë:

Fabrikë asfaltobetonit - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi ose sipas legjislacionit në fuqi.

Për fabrikën e asfaltobetonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumentin që vërteton pronësinë, Leje mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKL, QKB)(sipas legjislacionit në fuqi).

Nëse fabrika e asfaltobetonit nuk është në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton posedimin e fabrikës (Kontratë qeraje e vlefshme, marrëveshje furnizimi e vlefshme, etj.) (sipas legjislacionit në fuqi).

c) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera ose sipas legjislacionit në fuqi), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8):

- Kokore, minimumi 24 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

Shënim: Për pikën 2.3.5 (a, b dhe c) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5 (a, b dhe c), duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij / tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.5 (b) të shtojcës nr. 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ndër të tjera operatori ekonomik ankimues “Nika” SHPK ka dorëzuar:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në përmbushje të pikës së sipërcituar në DT, operatori ekonomik “NIKA” SHPK në pikën C “Deklaratë” në seksionin “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar mjetet, pajisjet teknike në dispozicion për realizimin e kontratës.
- Deklaratë doganore R ***, datë 11.06.2025 për makineri e përdorur (asfalt shtruese) V.P 2002=14620 kg neto
- Kontratë shitblerje (mjete), datë 11.04.2012 lidhur ndërmjet shitësit shoqëria “****” SHPK dhe blerësi shoqëria “Nika” SHPK për mjetet eskavator me zinxhir “Liebherr”, tipi 911 C/LC, viti 1979, nr. Shasie ***, eskavator me zinxhir “Komatsu”, tip, “raupenbagger”, viti 1987, nr. Shasie ***, rrul rugësh me shpatulla copë 1, Graber (Grejder).
- Deklaratë doganore nr. ***, datë 21.03.2008 për mjetin sheshues dhe nivelues vetëlëvizës (Graber Erdhobel).

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të 12 ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për

dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.9. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;
- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

- a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kw në rastin e një motori elektrik;*
- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kw, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kw, në rastin e një motori elektrik;*
- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kos, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*
- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kos, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*
- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*
- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm³*

dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kw, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kw, në rastin e një motori elektrik;

- Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kw;

b) - kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;

- kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;

- kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;

- kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;

c) - kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;

- kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;

- kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;

d) - kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,

- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;

- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

dh) - Kategoria T: traktorët me rrota;

- Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;

- Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;

- Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;

- Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë; Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.*

III.3.9. Në nenin 58 “Makinat teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “1. *Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.*

2. *Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:*

a) *makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;*

b) *makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;*

c) *motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.*

3. *Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjëse për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.*

4. *Për t’iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale*

III.3.10. Në nenin 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: 1. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.*

2. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.*

3. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.*

4. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.*

5. *Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjëse për transportin.*

6. *Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.*

7. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.

III.3.11. Në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “1. *Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit.*

2. Pronari i makinës teknologjike duhet të shënojë, në kërkesën e regjistrimit të mjetit, të dhënat e gjendjes civile dhe adresën.

3. Po në këtë kërkesë, nëse është e nevojshme, duhet të shënohen të dhënat e plota të ndërmarrjes së cilës i është besuar përdorimi i makinës teknologjike. Ky detyrim nuk kërkohet për makinat teknologjike, vetëlëvizëse, të pajisura me motor me fuqi jo më të madhe se 50 kë. Po kështu, ky detyrim nuk kërkohet për makina teknologjike, si vagoneta rrëshqitëse, motokarro, rula për të shtruar, makina për mbartjen e shinave dhe të ngjashme me to, për ato të caktuara për finiturën dhe trajtimin e mbulesës së rrugës, si dhe për makinat teknologjike që tërhiqen.

4. Në rastin e daljes nga qarkullimi të një makine teknologjike, pronari duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, si dhe të kthejë targën e regjistrimit dhe lejen përkatëse të qarkullimit. Zyra e mësipërme lëshon dëftesën përkatëse dhe merr masa për asgjësimin e targës, për anulimin e lejes së qarkullimit dhe ndryshimet që pasojnë, të cilat arkivohen në arkivin përkatës.

5. Për daljen e përkohshme nga qarkullimi të makinës teknologjike, pronari i makinës teknologjike duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, duke treguar depozituesin e mjetit në ruajtje, si dhe selinë e tij”.

III.3.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet se është plotësuar sipas Shtojcës 8 të

dokumenteve të tenderit. Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet, se ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Nika” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës me anë të shkresës nr.3714/4 prot., datë 19.01.2026, i kërkoj autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Nika” SHPK, i renditur i pari. Me shkresën me nr. 1024 prot., datë 26.01.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3714/5 prot., datë 28.01.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” SHPK në përmbushje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.3.14 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin administrativ, Komisioni konstaton se, operatori ekonomik “Nika” SHPK ka dorëzuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time, se kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshtë: në pronësi.....2. asfaltoshtruese – R ***, datë 11.06.2025. 4. Grejder – kontratë shitblerje mjeti, e datës 11.04.2012. Gjithashtu në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruara në shtojcën 8, si dhe dokumentat shoqëruese të ofertës.

III.3.15. Nisur nga arsyetja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nika” shpk nga KVO-ja me arsyetimin si vijon: “Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma “a” të DST-së, për disponimin e mjetit “Greider”, OE ka dorëzuar vetëm faturën doganore nr. R19897, datë 21.03.2008. Bazuar në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makunave teknologjike” përcaktohet se: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit”. Pra, si dokumentacion provues për mjetin “Greider”, OE NIKA SHPK, me NUIS J76705047U në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon. Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma “a” të DST-së, për disponimin e mjetit “Asfaltoshtruese”, OE ka dorëzuar vetëm faturën doganore nr. R77259,

datë 11.06.2025. Bazuar në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” përcaktohet se: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e rregjistrimit”. Pra, si dokumentacion provues për mjetin “Asfaltoshtruese”, OE NIKA SHPK, me NUIS J76705047U në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP-së nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 1024 prot., datë 26.01.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3714/5 prot., datë 28.01.2026 të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” SHPK në përmbushje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe neni 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit sa më sipër ndër të tjera operatori ekonomik “Nika” SHPK ka dorëzuar Deklaratë doganore R ***, datë 11.06.2025 për makineri e përdorur (asfalt shtruese) V.P 2002=14620 kg neto, Kontratë shitblerje (mjete), datë 11.04.2012 lidhur ndërmjet shitësit shoqëria “****” SHPK dhe blerësi shoqëria “Nika” SHPK për mjetet eskavator me zinxhir “Liebherr”, tipi 911 C/LC, viti 1979, nr. Shasie ***, eskavator me zinxhir “Komatsu”, tip, “raupenbagger”, viti 1987, nr. Shasie ***, rrul rugësh me shpatulla copë 1, Graber (Grejder), Deklaratë doganore nr. ***, datë 21.03.2008 për mjetin sheshues dhe nivelues vetëlëvizës (Graber Erdhobel).

III.3.16. Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ, KPP gjykon, se lidhur me arsyen e skualifikimit të KVO-së se për sa i përket mjetit të pretenduar “Grejder” dhe “Asfaltoshtruese” që nuk përmbushin dokumentacionin teknik të kërkuar, në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon, Komisioni gjykon, se referuar neni 58, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në këtë dispozitë përcaktohet se cilat mjete klasifikohen si “mjete teknologjike” dhe fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton dhe detyrimin që të pajisen me targa, ndërkohë që në interpretim të përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të gjitha kategoritë e mjeteve (të përcaktuara në neni 47 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar) përfshirë dhe mjetet teknologjike në momentin kur qarkullojnë në rrugë duhet të jenë të pajisur me targa, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa. Edhe neni 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se “Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit”. Përsa kohë objekti i procedurës së prokurimit është “Rikonstruktion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier”, do të thotë që mjetet asfalto shtruese dhe grejder do të lëvizin në rrugë, pra nuk kemi të bëjmë me një kantier ndërtimi që do të ishte një vend shesh i rrethuar për ndërtimin e një objekti por kemi të bëjmë me punime në rrugë, rrjedhimisht makinat teknologjike vetëlëvizëse grejder dhe

asfaltoshtruese do të qarkullojnë në rrugë dhe do të duhet të pajisen me targa sipas parashikimeve të pikës 3 dhe 4 të nenit 113 të Kodit Rrugor ku parashikohet shprehimisht se: *“3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8. 4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.”*. Edhe neni 282 *“Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike”* të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 *“Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar parashikon se *“Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit”*. Neni 113 i Kodit Rrugor e parashikon shprehimisht që për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit, pra e lidh detyrimin me qarkullimin në rrugë, në rastin konkret referuar objektit të procedurës së prokurimit *“rikonstruksion rruge”*, makina vetëlëvizëse do të qarkullojë në rrugë, i cili do të jetë vendi ku do të kryhen punimet. Edhe në rastin kur asfaltoshtruesja apo grejderi nuk është ende e regjistruar minimumi që Kodi lejon për lëvizje në rrugë pajisja me fletëudhëtimi dhe targë e përkohshme. Përpara se të futen në qarkullim makinat teknologjike duhet të kryhet verifikimi i të dhënave dhe përshtatshmërisë, si: të dhënave të identifikimit, të fuqisë së motorit kur duhet, të përputhjes me kushtet/karakteristikat teknike, ky verifikimi kryhet gjatë kontrollit dhe provave nga ana e organeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të nenit 106 të Kodit Rrugor.

Sa më sipër analizuar, në rastin konkret referuar objektit të procedurës së prokurimit *“Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier”*, mjetet grejder dhe asfaltoshtruese do të qarkullojnë në rrugë, që përbën objektin e punimeve dhe rrjedhimisht do të duhet të regjistrohen, të pajisen me leje qarkullimi dhe targë njohje, në zbatim të dispozitave e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111, 113 të Kodit rrugor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Nika” SHPK* nuk qëndron.

III.4. Lidhur për pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Nika” SHPK* për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se: *“[...] Se treti: Persa i perket pretendimit se OE nuk ka paraqitur formularin e ofertes dhe listen e cmimeve te korrigjuar me dokumentacionin e dorezuar fizikisht, edhe ky pretendim nuk eshte i drejte, per shkak se ne momentin qe nga AK eshte kerkuar qe te paraqitet Formulari i ofertes dhe lista e cmimeve e korrigjuar, ato jane pranuar korrigjimet dhe jane kryer nga shoqeria Nika, si dhe i eshte derguar AK. Njekohesisht me dosjen fizike eshte derguar edhe formulari dhe lista e cmimeve me gabime ne llogaritje. Per me teper vleresojme se ky pretendim nuk eshte nje shkak ligjor qe mund te ngrihet ne nivelin e skualifikimit, pasi AK i kishte keto dokumenta te dorezuara edhe*

me perpara dhe kjo mund te behej me kerkese te re per dorezim dokumentacioni dhe dokumentacioni ishte gati. Bashkengjitur kesaj ankese po ju dergojme edhe dokumentat e korrigjuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në shtojcën nr. 1 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe shtojcën nr. 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t’ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Vlerësimit;
4. Kriteret e Përzgjedhjes;
5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
6. Preventivin e çmimeve
7. Termat e referencës (nëse është rasti)
8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____*Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.**Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.**Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.***Oferta ekonomike e detajuar**

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën _____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.4.1 Në shtojcën 7 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.4.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

g) *operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

gj) *operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.
- Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin

ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.4.5. Nisur nga arsyetja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues me arsyetimin se: *“OE nuk ka paraqitur formularin e ofertes dhe listen e cmimeve të korigjuar me dokumentacionin e dorëzuar fizikisht”*, si dhe nga verifikimi në SPE në rubrikën “kërkesa”, Komisioni konstaton se në datë 10.11.2025 KVO i ka dërguar në SPE operatorit ekonomik ankimues kërkesën *“Për korrigjimin e gabimit aritmetik në lidhje me ofertën e paraqitur”*. Në datë 11.11.2025 operatori ekonomik “Nika” SHPK ka dorëzuar në SPE shkresën me lëndë: *“kërkesë për dorëzim dokumentash përcjellëse-saktësuese”*, bashkëlidhur preventivi i punimeve të korigjuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 1024 prot., datë 26.01.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3714/5 prot., datë 28.01.2026 me të cilën autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” SHPK në përmbushje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, rezulton se operatori ekonomik ankimues si operatori ekonomik i kualifikuar i pari, ka dorëzuar pranë autoritetit “Formularin e ofertës”, me gabime aritmetike.

III.4.6 Referuar pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë autoriteteve kontraktore dokumentet provuese të përmbushura me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave me arsyetimin se *“OE nuk ka paraqitur formularin e ofertes dhe listen e cmimeve të korigjuar me dokumentacionin e dorëzuar fizikisht”*, Komisioni gjykon se referuar pikës 3 të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, gjithashtu referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në këto kushte autoriteti kontraktor në momentin që konstaton se dokumentet e dorëzuara fizikisht nuk përputheshin me dokumentet e ngarkuara në SPE nga operatori ekonomik në momentin e ofertimit duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Nika” SHPK lidhur me dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 04.12.2025. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se përsa i përket dokumentave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Nika” SHPK pranë autoritetit kontraktor konkretisht formulari i ofertës me gabime aritmetike, Komisioni gjykon, se ky është një dokument të cilin operatori ekonomik “Nika” SHPK e ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik në momentin e dorëzimit të ofertave, rrjedhimisht autoriteti kontraktor ka patur mundësinë e verifikimit të tyre dhe vlerësimit në fazën e parë procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bazuar në legjislacionin për prokurimin publik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij autoriteti kontraktor përcakton në dokumentat e tenderit kriteret të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të cilat i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen për përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorit ekonomik. Në rastin konkret referuar dokumentave të tenderit dhe arsyes së skualifikimit Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e tyre në fazën e parë të vlerësimit të ofertave dhe në momentin që ka konstatuar gabime aritmetike në ofertë ka njoftuar operatorin nëpërmjet SPE për korrigjimin e tyre. Nga verifikimi në SPE rezulton, se operatori ekonomik ka pranuar korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ka ridërguar në SPE “Formularin e ofertës ekonomike” të korrigjuar. Në kushtet kur operatori ekonomik e ka dorëzuar në SPE “Formularin e ofertës”, si dhe është verifikuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni gjykon, se mos dorëzimi i këtij dokumenti fizik pranë autoritetit kontraktor nuk ndikon në mospërmbushje të kriterëve të përgjithshme/veçanta të kualifikimit apo specifikime teknike, përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare;

aftësinë teknike dhe profesionale. Sa më sipër cituar Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Nika” SHPK, si dhe plotësimin e dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetut kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “NIKA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-65205-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion Rrugës "Safet Alushi", fshati "Drizë", Njësia Administrative Qendër, Fier” me fond limit 57,650,770.11 (*Pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biba-X” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biba-X” Shpk.
7. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nika” Shpk.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

